



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

Asambleja Europiane e SME-ve

Editorial

Më datat 22-24 Nëntor 2017, në kuadrin e Javës Europiane të SME-ve, në Talin të Estonisë u mbajt Asambleja Europiane e SME-ve. Ky takim mjaft i

rëndësishëm u organizua nga Estonia si vend që ka presidencën e radhës të Këshillit të Komisionit Europian. Ky është viti i gjashtë që organizohet

Asambleja e SME-ve

Europiane. Motoja e këtij viti ishte **"Start. Scale. Spread your wings"**.

Shqipëria u përfaqësua me presidenten e SHGPAZ znj. Flutura Xhabija, anëtarën e bordit të SHGPAZ znj. Elida Madhi si dhe me Sekretaren e Përgjithshme të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, znj. Albana Laknori.



Në Asamble morrën pjesë politikanë të nivelit të lartë nga Komisioni Europian dhe nga të gjitha vendet anëtare. Së bashku me rrjetin e SME Envoys, asambleja krijoi the

strukturën qeverisëse të Small Business Act (Aktit të Biznesit të Vogël).

Asambleja u fokusua se si të

bëjë që politikën e SME-ve të funksionojnë në mënyrë që SME-të e Europës të lulëzojnë. Më tej në Sipërmarrjet Inovative, në ceremoninë e shpërndarjes së çmimeve për Nxitjen e Sipërmarrjeve Europiane, u zhvilluan disa seksione interaktive për politikën të ndryshme në mbështetje të zhvillimit të mëtejshëm të SME-ve në Europë. *(Vijon faqe 2)*

Buletin Informativ

Nëntor 2017

NË KËTË NUMËR

Paniret në Turqi për muajin - dhjetor 2017

Kalendari i panireve në Turqi për muajin dhjetor 2017. Faqe 10



"Donne D'Albania" Gratë shqiptare në Itali

Takim për prezantimin e librit "Donne d'Albania. Tra migrazione, tradizione e modernità" Faqe 5



SME inovative në Estoni

(vijon nga faqe 1)

Estonia: një shtet ish-rus, por me një kulturë vetjake estoniane; një vend me 1.3 milion banorë, ku dimri zgjat 7 muaj, me hapsirë të madhe, por me njerëz të thjeshtë, punëtorë, të edukuar e shkolluar, të qetë dhe jashtëzakonisht produktiv. Ministria e sipërmarrjes ishte një eksperte e IT-së bëri një diskutim të shkurtër e sintetik; vendi i saj shet inteligjencën e vet, talentet e shumta, përkushtimin e paparë, ku tokën bujqësore e ka të limituar dhe detin me pash, por ka dëshirën për punë; askush nuk flet për politikën, por për sfidat e të ardhmes.

Kompanitë inovative Estoniane prezantuan punën e tyre në një panair të hapur për këtë qëllim. Shembulli i “*e-Estonia*” e i shkallës së dixhitalizimit të sipërmarrjeve estoniane është një nga shembujt më mbresëlënës të



zhvillimit të sipërmarrjeve inovative dhe kontributit të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

Si konkluzion vendet e BE-së duhet të bëhen më konkurruese dhe në këtë kuadër ato vlerësuan 10 idetë më të mira të sipërmarrësve më vizionare në Europë.

Vazhdon procesi i vetëvlerësimit të SBA



Procesi i vetëvlerësimit të politikave të implementimit të SBA vazhdon, në vijim të takimit të Komisionit European dhe OECD lancuan në Tiranë për procesin e vetëvlerësimit të SBA 2017-2020. Përfaqësues të institucioneve tëndryshme qeveritare, si dhe përfaqësues nga biznesi, po bëjnë vetëvlerësimin e politikave përkatësisht nga institucionet e tyre. Ky proces kryet rregullisht nga CE-ja dhe përfshin vetëvlerësim e institucioneve qeveritare për politikën e ndërmarra për lehtësimin e të bërit biznes në Shqipëri, si dhe survey me opinionet e biznesit, se si janë perceptuar këto politika dhe në fund jepet vlerësimi i CE dhe ekspertëve të OECD.

Platforma “Harta e inovacionit në Shqipëri”

Më datat 13-14 nëntor 2017, në kuadër të projektit “Shqipëria Sipërmarrëse”, Qendra Shqiptare e Kërkimeve dhe Trainimeve për Biznesin (ACBRT) prane Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në bashkëpunim me Organizatën Sllovaqe për Kërkim dhe Zhvillim (SORD) organizuan Konferencën për prezantimin e Platformës “Harta e inovacionit në Shqipëri”.

Qëllimi i përgjithshëm i Konferencës ishte të paraqiste produktin e platformës “Innovation map Albania” si një platformë unike që harton ekosistemin e inovacionit në Shqipëri, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin në tema të zgjedhura me synimin për të ofruar shërbime individuale të ekspertëve dhe mentorimit për palët e interesuara të ekosistemit të inovacionit.

Kjo konferencë konsistoi në një program dy-ditor gjatë të cilit u prezantuan projekti & platforma e zhvilluar në kuadër të tij gjatë ditës së parë, e ndjekur nga prezantime kyçe dhe një sërë workshopesh gjatë ditës së dytë.

Përgjatë këtij programi pati gjithashtu mundësi që të njiheshim me përvojat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare të prezantuara nga ekspertë rajonale si dhe të ndahej përvojat dhe sfidat tuaja, mbi të cilat më pas do të ofrohen konsultime individuale.

Platforma mund të gjendet në website <https://innovationmapalbania.org>

Qëllimi i kësaj platforme është që të krijohet partneritet midis aktorëve të ndryshëm biznese-Dhomë tregtie-universitete. Të shkëmbejnë eksperiencat më të mira midis anëtarëve të platformës. Të gjenden ekspertizat, mentorimi dhe trainime për sektorë e problematikë të ndryshme. Si rrjedhim të shërbejë për krijimin e bizneseve inovative.



Rubrikat ku mund të regjistrohen sipërmarrësit janë :

- Start ups
- Funding
- Ecosystem

Qëllimi i takimit dhe workshopëve ishte që të përfshihen sa më shumë sipërmarrës, ekspert, trainerë, Organizata në shërbim të biznesit, banka, donatorë etj. Në këtë hartëzim të ekosistemit të inovacionit në Shqipëri.

Bashkohuni drejt sipërmarrjes inovative !



Mëngjes pune me Ministren e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes


Më 7 Nëntor, 2017 Forumi Kombëtar i Biznesit (NBF) organizoi një mëngjes pune me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes znj. Sonila Qato, i cili kishte si qëllim prezantimin e problematikave kryesore të biznesit nga anëtarët e NBF. Pikat kryesore të takimit listohen si më poshtë:

- Profesionalizmi dhe etika e punonjësve të administratës publike
- Rimbursimi i TVSH
- TVSH e Nënkontraktorëve të Fasonit

- TVSH e Turizmit dhe Kontrollet Tatimore
- Dialogu publik privat dhe

- Implementimi efektiv i ligjit mbi njoftimin dhe konsultimin publik
- Ulja e pragut të TVSH në 2 milion lek

Paqëndrueshmëria e Legjislacionit



65 vjetori i Organizatës Botërore të Grave Biznes e Zhvillim

Më datat 19-20 Nëntor 2017 u festua në Romë 65 vjetori i Organizatës Botërore të Grave Biznes e Zhvillim (FCEM).

Gjatë këtyre ditëve u promovuan biznese femërore artizane dhe jo vetëm. SHGPAZ morri pjesë me një delegacion të grave sipërmarrëse të udhëhequra nga Presidentja e shoqatës znj. Flutura Xhabija.

*Artizane, jane edhe keta, ne rrugicat turistike romane!
Pasta artigianale! Che bello!*



Publikimi “Donne D’Albania” Gratë shqiptare në Itali

Më datë 10 nëntor 2017, u mbajt në Tiranë takimi për prezantimin e librit "Donne d'Albania. Tra migrazione, tradizione e modernità" organizuar nga Institucioni italian "Confronti". Në këtë takim pati diskutime, refleksione, shkëmbime idesh, për rolin dhe situatën e grave e vajzave shqiptare.

Sipas Anila Husha, një intelektuale shqiptare që punon e jeton në Itali e cila i referohet burimeve zyrtare italiane, numri i qytetarëve shqiptarë në Itali më 1 janar 2017 rezultoi në 448,407, ku gratë shqiptare përbëjnë 48,1%. Komuniteti shqiptar renditet i dyti pas atij rumun. Nga një analizë e

nxënës në shkollat italiane. Nga një studim i kryer nga nga Universiteti Roma Tre, rezultoi se komuniteti shqiptar është më prezent në sistemin shkollor dhe me rezultatet nga më të mirat. Prezenca e lartë e të miturve në komunitetin shqiptar dhe pjesëmarrja e tyre e rregullt në sistemin shkollor është një faktor i rëndësishëm i integritetit të komunitetit shqiptar në Itali. Familjet shqiptare ruajnë akoma modelin tradicional, atë të bashkëjetesës me prindërit, të cilët shërbejnë edhe si amortizues sociale.

Për qytetarët shqiptar motivi familjar rezultoi motivi kryesor i qëndrimit në Itali. Gratë shqiptare të punësuar përbëjnë vetëm 33% të punësuarve ndërsa meshkujt shqiptar 67%. Një pjesë e mirë e grave, sidomos e nënave të reja me fëmijë në moshë deri në 3 vjeç, në mungesë të çerdheve shtetërore janë të detyruara të mbajnë fëmijët në shtëpi. Pjesa tjetër punojnë në të zezë, sidomos në familjet italiane duke u përkujdesur për të moshuarit, fëmijët dhe për familje të tëra.

Në vitet e fundit kriza ekonomike ka bërë që të evidentohet fenomeni i grave emigrante që nga shtëpiake shndërrohen në subjekte kryesore



në kërkim të punës. Shpesh ndodh që meshkujt humbin vendin e punës, ndërsa gratë mbajnë peshën e familjes. Pra mund të thuhet që në një farë mënyre kriza ka ndihmuar në emancipimin e familjeve shqiptare në Itali.

Pjesa më e madhe e grave emigrante edhe pse jetojnë prej shumë kohe në Itali dhe me një nivel shkollor të lartë hyjnë në sektorin e bashkëpuntores familjare dhe mbeten të bllokuara edhe pse është një sektor pak i kualifikuar e i keqpaguar.

Në tregun e punës gjenden edhe shumë gra sipërmarrëse, gra të cilat pas shumë vitesh me sakrificë, punë e studime vendosin të krijojnë biznesin e tyre.

Janë krijuar **33,307 biznese shqiptare në Itali**, nga të cilat **4,000** janë të drejtuara nga gra, që përbëjnë **12%** të totalit. Sektorët më të suksesshëm janë

shërbimet, turizmi, ushqimi etj. 20% e grave sipërmarrëse shqiptare janë me diplomë universitare.



mëtejshme
rezultoi se 50.6% e

grave shqiptare në Itali kanë moshën mesatare deri në 30 vjeç, ndërsa 31,8% kanë moshën nga 30-49 vjeç. Përqindja e të rinjve nën moshën 18 vjeç është në një nivel të lartë dhe përbën 27,7% të gjithë komunitetit shqiptar, ku 78,4% e tyre janë të regjistruar si



Taksimi i ri i pronës rëndon familjarët

Kadastra fiskale ose regjistri që nuk dihet kur do përfundojë

nga **Violeta Shqalsi**

Shqiptarët do të paguajnë të paktën 21 milionë euro më shumë si taksë prone në buxhetin e vitit të ardhshëm. Këtë parashikim ka bërë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në ligjin për buxhetin të vitit 2018 ku totali i të ardhurave në këtë zë është parashikuar rreth 60 milionë euro. Sipas tabelave të reja të buxhetit, arkëtimi nga taksë e pronës në 2018-n pritet të rritet me 54%, për të arritur në 8.1 miliardë lekë, nga 5.3 miliardë lekë që pritet të mbliidhen këtë vit. Qeveria synonte që të reformonte taksimin e pronës për vitin e ardhshëm, por duket se e vetmja pjesë me reformim do të jetë taksë e ndërtesës, ndërsa taksë që paguhet për tokë truall dhe tokë bujqësore do të mbeten sipas modelit të vjetër. Në Paketën Fiskale të vitit 2018, qeveria ka zyrtarizuar se shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është 0.05% për ndërtesën ku taksapaguesi ka banimin e përhershëm, ose zakonisht banon dhe 0.2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.

Taksën për ndërtesën duhet ta paguajnë individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive të paluajtshme, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Por taksën do ta

paguajnë edhe ata të cilët nuk kanë marrë në dorë një dokument ligjor për legalizimin, por kanë aplikuar në këtë proces. Të paktën 350 mijë ndërtime janë në proces legalizimi dhe ende nuk kanë marrë leje.

Në momentet e fundit qeveria rriti numrin e atyre që do të paguajnë duke shtuar edhe ndërtuesit që nuk kanë respektuar afatet për lejen që kanë marrë. Sipas përcaktimit, kjo kategori do të paguajë 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Kjo është bërë me argumentin e nxitjes së ndërtuesve në respektimin e afateve të lejeve që përfitojnë, thuhet në relacionin e paketës fiskale.

Aktualisht në Shqipëri, ka qytetarë që kanë në pronësi më shumë se një banesë, dyqan apo prona të tjera të patundshme dhe nuk paguajnë taksë për to. Kjo do të thotë humbje e konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Sipas të dhënave zyrtare të dikasterit të financave, të ardhurat që mbliidhen nga taksë e pasurisë janë ndjeshëm më të ulëta se niveli i taksave të tjera. Për 10 mujorin e këtij viti, nga kjo taksë janë futur në buxhet 4.2 miliardë lekë, duke qenë viti me



nivelin më të lartë të arkëtimeve në vitet e fundit. Për shkak të numrit të madh të ndërtimeve informale, Shqipëria është një nga vendet me nivelin më të ulët të të ardhurave nga taksat mbi pronën.

Referuar dhe analizave të bëra nga MF, taksat vendore mbi pasurinë e paluajtshme janë një burim i preferueshëm të ardhurash për disa arsye. Në rradhë të parë, baza tatimore është e dukshme për çdokënd dhe është e vështirë t'i shpëtosh detyrimit tatimor që aplikohet ndaj pasurisë së paluajtshme. Nga këndvështrimi administrimit tatimor procesi i tatimit të pronës është më i lehtë pasi barra tatimore është e bashkëlidhur me pronën.

Interesi i pushtetit vendor për të mbledhur të ardhura tatimore nga pronat është një burim i qëndrueshëm të ardhurash.

Pensionistët e vetmuar, familjet me ndihmë ekonomike, banesat sociale, si dhe kategoria e invalidëve do të përjashtohen nga tatimi mbi ndërtesën. Taksës së pronës do t'i nënshtrohen edhe ato familje që janë në proces legalizim. Ndërsa ajo do të përfshihet tek fatura e energjisë elektrike dhe do të paguhet çdo muaj ose një herë në tre muaj.

FAKTE

26.8%

Biznese aktive të drejuara/pronare gra, për vitin 2016 në Shqipëri rezultojnë 26.8% me një rënie me 4.5 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT 2017)



OJF në Dobi të Gruas Shqiptare

Shoqata "Në Dobi të Gruas Shqiptare" mbajti Asamblenë e saj më 17 nëntor 2017.



3.2%

Rritja e kredisë për vitin 2016 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më pare. (Banka e Shqipërisë, 2017)



2018, Viti i Gruas dhe i Medias

Vazhdon lobimi i 10 shoqatave të grave një iniciativë, me gra, përfaqësuese të fushave e sektoreve të ndryshëm, aktiviste të njohura ose të reja të devotshme, të cilat realisht shqetësohen për situatën ku ndodhet

gruaja në këtë gati fund dekade të tretë të demokracisë shqiptare.



Iniciativa ka të bëjë me shpalljen e 2018, si Vit' i Gruas e i Medias, si dhe të hartonim një strategji e cila hap pas hapi, do të përmblihte atë që ne duam të arrijmë, mes përpjekjesh e lobimesh për Vitin e Gruas e të Medias, 2018, për të diskutuar, ndarë dhe vendosur platformën që ne duam të ngrejme e të punojmë për të justifikuar këtë nisme, në kuadrin e 15 Ditëve Ndërkombëtare Kundër Dhunës Ndaj Grave, dhe do bëhet në Pallatin e Kongreseve.

Gruaja dhe shëndeti

Diabeti dhe bima e argjinares

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Vitet e fundit diabeti është bërë një nga sëmundjet më të frikshme, me tendencë të lartë për të prekur edhe moshat e reja. Diabeti i tipit 2 është një nga format më të përhapura të diabetit. Diabeti në botë prek 1 në 11 persona dhe po përhapet në mënyrë të frikshme. Pritet që ky numër të rritet për shkak të mënyrës së keqe të të ushqyerit, si dhe jetës pasive. Çdo vit vdesin 3.7 milion njerëz në të gjithë botën. Edhe numri i diabetikëve në Shqipëri është rritur ndjeshëm gjatë vitet e fundit dhe numërohen rreth 4,000-5,000 raste të reja në vit.

Diabeti është një gjendje shëndetësore serioze, e cili po nuk u trajtua, mund të çojë në zhvillimin e sëmundjeve të zemrës, verbëri, mosfunksionim veshkash dhe komplikime të tjera që rrezikojnë jetën. Diabeti mund të shfaqet tek gratë gjatë periudhës së shtatzënisë, gjë që trefishon rrezikun për të pësuar atak në zemër, goditje në tru, si dhe probleme me veshkat.



Diabeti i sheqerit (diabetes mellitus) është një çrregullim metabolik, që karakterizohet me rritjen e nivelit të sheqerit në gjak dhe që shoqërohet me çrregullime të metabolizmit të karbohidrateve (sheqernave), yndyrave dhe proteinave. Kjo sëmundje vjen si pasojë e defektit në sekretimit të insulinës, e cila është një hormon që sekretohet normalisht nga pankreasi dhe që konsiderohet çelësi për futjen e glukozës në qelizë. Vetëkujdesi në marrjen e ushqimit të shëndetshëm ndikon deri në 50% për mbajtjen nën kontroll të sëmundjes.

Shenjat paralajmëruese të diabetit: probleme me lëkurën, etje e tepërt, rënie në peshë, uri e tepërt, probleme me shikimin.

Kush rrezikohet nga diabeti: njerëzit mbi moshën 45 vjeç, por tashmë edhe më herët; ata që e kanë trashëgimi nga familja; ata që janë mbipeshë; gratë që kanë pasur diabet shtatzënie apo që kanë lindur fëmijë mbipeshë.

Trajtimi: Nëse një person është diagnostikuar si diabetik, fillimisht, si formë trajtimi rekomandohet ndryshimi i menjëhershëm i stilit të jetës, pra kujdesi i përpiktë në marrjen dhe zgjedhjen e ushqimit të shëndetshëm dhe aktiviteti fizik. Pastaj, nëse kjo formë e trajtimit nuk funksionon fillohet me mjekimin me barna, nëse është



diabet tip 2. Nëse është diabet tip 1, duhet të fillohet menjëherë me insulinë. Ndryshimi mes këtyre tipeve qëndron në rezistencën e veprimit të insulinës ose pakësimin e sekretimit të saj, që është karakteristikë e tip 2, si dhe mungesën e plotë të sekretimit të insulinës që është tip 1.

Argjinaria apo karçofi ka veti të larta parandaluese dhe trajtuese të sëmundjeve. Pjesa e ngrënshme e argjinares ndodhet tek pjesa e kurorës së lules para çeljes. Pra duhet patur kujdes që argjinaria të konsumohet para se lulet të çelin, sepse pasi ato çelin ajo bëhet e fortë dhe është e pamundur të konsumohet.

Argjinaria forcon sistemin imunitar, ul kolesterolin, mbron nga **diabeti** etj. Ajo rekomandohet shumë si ushqim me të gjithë pacientët që kanë probleme me luhatjet e shpeshta të sheqerit në gjak. Kjo sepse ajo ka veti tretëse dhe diuretike, ndërsa rigjeneron mëlçinë, tëmthin dhe pankreasin. Përbërësi që ka edhe vetitë kryesore ushqyese është inulina, një fibër prebiotike e tretshme e nevojshme për dietat diabetike.

Konsumohet e zierë si sallatë me vaj ulliri, si dhe pihet lëngu i saj gjysëm ore para ushqimit.

Forumi Kombëtar i Biznesit

Në 21-22 Nëntor 2017, Forumi Kombëtar i Biznesit (NBF) me mbështetjen e CiPE organizoi një trajnim 2 ditor me anëtarët e

Forumit për të fuqizuar kapacitetet e anëtarëve të

NBF, për tejkalimin e problematikave që ndeshin në organizatat e tyre në bazë të vlerësimeve paraprake të bëra në këto organizata.

Gjate dy ditëve të trajnimit Z. Harris përcolli në mënyrë shumë të thjeshtë pikat kryesore që një Shoqatë/



Dhomë tregtie duhet të forcojë në mënyrë që të ketë sukses në funksionimin e saj. Gjithashtu gjatë ditës së dytë u bë dhe një vlerësim i punës së NBF dhe vazhdimësisë së tij.



Buletin Informativ

Nëntor 2017



Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com

Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia

PANAIRET NE TURQI PER MUAJT NENTOR - DHJETOR 2017						
panair / event	qyteti	Date	Sektoret	Programi	Afati i aplikimit	kush
Adana Tarım Fuarı, 11. Tarım , prodekte bujqesore dhe buke	Adana	8-12 November 2017	Agriculture and stock breeding	7 November : Arrival 8 November : B2b's 9 November : Visittothefair 10 november: Departure	29 October, 2017	kompanite
Sırha –Istanbul 2017 Hotel-Restoran dhe Catering	Stamboll	16-18 november 2017	Pajisje ushqimi, sherbi mi hotelesh , restoran dhe catering	15 November: Arrival 16 November : B2b's 17 november: Visittothefair 18 november: Departure	3 November, 2017	kompanite
Nfv Exco 2017	Stamboll	21-22 November 2017	Nuts, Fruitsandvegetables	20 November: Arrival 21 november: B2b's 22 November : Visittothefair 23 november: Departure	14 November, 2017	kompanite
Hpkon 2017	Izmir	22-25 November 2017	Hydraulics , Pneumatics	21 November: Arrival 22 November : B2b's 23 november : Visittothefair 24 november: Departure	10 November, 2017	kompanite
5.Oic	Stamboll	23-25 November 2017	Halalfood, Halalturism, Hala Finance, Halaltextile	22 November: Arrival 23 November: B2b's 24 November : Visittothefair 25 november: Departure	13 November, 2017	kompanite shoqata/institucione
Flower Show Istanbul 2017	Stamboll	23-25 November 2017	Plants, Landscapingandsupportingindustries	22 November : Arrival 23 November : B2b's, Participationtocongress 24 November : Visittothef 25 November: Departure	10 November, 2017	kompanite
Bursa 9.Sac İşleme Teknolojileri Fuarı	Bursa	30 November-03 December 2017	Sheet Metal Processing Technologies	29 November: Arrival 30 November : B2b's 1 December : Visittothefair 2 December: Departure	17 November, 2017	kompanite
Otomasyon Fuarı 2017, Bursa 15.	Bursa	30 November 03 December	Electric-Electronic dhe makineri automatike	29 November : Arrival 30 November : B2b's 1 December : Visittothefair 2 December : Departure	17 November , 2017	kompanite
Uluslararası Silmoistanbul Optik Fuarı	Stamboll	30 November 03 December	Optics, Precisionmechanisms, Laser	29 November : Arrival 30 November : B2b's, Participationtocongress 1 December : Visittothefair 2 December : Departure	22 November , 2017	kompanite
Fespa Eurasia – Dijital, Serigrafi, Tekstil Baskı Ve Endüstriyel Reklam	Stamboll	7-10 December , 2017	Digital, Serigraphy, Textile Printing Andindustrialadvertisement	06 December: Arrival 07 December : B2b's 08 December : Visittothefair 09 December: Departure	28 November, 2017	kompanite
Gapshoes 26. Uluslararası Ayakkabı, endüstri ushqimore	Gazi antep	13-16 December 2017	Footwear, Slipper,Saddler dhe food wearindustry	12 december : Arrival 13 december : B2b's 14 december : Visittothefair 15 december: Departure	1 December, 2017	kompanite
Hefi 1. Ev Elektroniği Fuarı	Stamboll	21-24 december 17	elektroshtepiake	20 December : Arrival 21 December : B2b's 22 December : Visittothef 23 December: Departure	8 December, 2017	kompanite